

## **DISA KËSHILLA**

Me këto këshilla do jetë i mundur kujdesi i lëkurës gjate radioterapisë:

### **Delikatesë**

✿ *Lekura në zonën e terapisë duhet të lahet me ujë as shumë te nxehtë as shumë të ftohtë, me sapun delikatë, duke evituar sfungjerë dhe duhet të thahet me nje copë ose napë pa e fërkuar.*

✿ **Nuk** është e këshillueshme të perdoren ilace ose krem për te lehtësuar dhimbjem dhe skuqjen.

✿ **Nuk** është e këshillueshme që në këtë periudhë të perdoren parfume, locione, dhe deodorante pasi të gjitha kanë bazë alkalike dhe irritojnë lekuren.

✿ Sygjerohet te evitohen mjekime shtepiace si psh: kremëra me baze vaji, vezë etj: personeli i radioterapise do ju sygjeroje cilat produkte dhe kremëra mund të aplikoni ne zonën e rrezatuar. Ashtu siç do t' ju sygjeroje edhe produktet dhe mjekimet që do të perdorni per skuqjen dhe irritimin.

✿ Është mire që të paraqiteni përpara radioterapisë me lekuren e pastër dhe ta aplikoni kremin mbas terapisë.

✿ Ne rastet e irritimeve serioze mjeku radioterapist dhe infermieri du ju keshillojnë cilat mjekime dhe si duhet ti përdorni. Gjatë terapisë nese është e nevojshme mund të asistoheni dhe mjekoheni në ambulatorët e radioterapisë.

✿ Këshillohet mos të vendosen likoplaste ose fasho ne lekuren e rrezatuar.

### **Veshjet**

✿ Është e këshillueshme te zgjidhni veshje komode, me përbërje fibre naturale që lehtësojnë ajrosjen e lëkurës: preferohen sytjena të thjeshta dhe te buta, pa dekoracione që mund të irritojnë lekuren.

### **Dhe Dielli?**

*Ditët në diell, ne det në pishinë dhe në mal janë te lejueshme, duke ju kujtuar që lekura e rrezatuar është shumë delikate. Rekomandohet që të mos ekspozoheni direkt në diell përgjatë trajtimit dhe disa muaj pas përfundimit.*

*Edhe shume muaj pas përfundimit të radioterapise është e rëndesishme te aplikohen kremëra për mbrojtjen nga dielli me faktor mbrojtjeje te larte.*

*Është e mundur te futeni ne det ose ne pishine vetem ne rast se nuk keni irritime ose skuqje te komplikuar te lekurës.*

### **Drejtori i Radioterapisë Onkologjike 1**

*Dr. Riccardo Valdagni*

### **Përgjegjësi i s.s Repartit Tumorit te gjirit**

*Dr.ssa Laura Lozza*

### **Mjekët referues për patologjitë e sëmundjeve të gjirit**

*Dr.ssa Anna di Russo, Dr.ssa Fulvia Soncini*

*Dr.ssa Carmen De Santis*

### **Infermjeria**

*Sra. M. Emanuela Visentin*

### **SEKRETARIA**

*Znj. Donatella Orlandi, Znj. Patrizia Riva*

*Orari: 8.30/16:30*

*Tel: +39 02 23902480*

*Falenderojme Znj. Elvira Brasca per projektin grafik  
Përkthyer nga Igli Kreka*

# TRAJTIMI ME RREZATIM I TUMORIT TË GJIRIT

*Ashtu si edhe për shumë neoplazi te tjera, Ra-  
dioterapia ka një rol te rëndesishëm përgjatë  
trajtimit terapeutik te tumorit të gjirit dhe  
integrohet me kirurgjinë (konservative ose  
mastektotominë) dhe me terapitë sistematike  
(kemioterapia dhe hormonoterapia), me mënyra  
specifike per situata të ndryshme klinike.*

## Kë do takoj?

**Radioterapisti onkolog** është mjeku i specializuar i cili përshkruan terapinë radiante (rrezatuese), studion shpërndarjen e përshtatshme të dozës në bazë të pacientit dhe fizikut të tij dhe ndjek vazhdimin e terapisë.

**Fizikanti sanitar** bashkëpunon me mjekët radio-terapistë për sa i përket hartimit të planit të trajtimit të pacientit.

**Tekniku sanitar i radiologjisë mjekësore**, bashkëpunon me mjekun radioterapist për procedurat paraprake (simulimi, adaptimi i organeve) dhe është përgjegjës për kryerjen ditore të procedurave sipas menyrave të përshkuara.

**Infermieri** ndihmon pacientet përgjatë vizitave të programuara të terapisë dhe jep suportin e tij në menaxhimin e efekteve anësore/ kolaterale.

**Personeli administrativ** është prezent në sekretari dhe kujdeset për aspektet administrative në lidhje me pacientet në pritje si dhe atyre në fazë trajtimi.

## Si bëhet radioterapia?

**TAK-u** i simulimit është procedura e parë që bëhet për planifikimin e trajtimit. Është një procedurë e shkurtër, pa dhimbje që nuk ka qëllim diagnostik por ka si qëllim të identifikojë zonat që duhen mbrojtur si dhe volumin e trajtuar gjatë radioterapisë.

Fizikantët dhe mjekët radioterapistë hartojnë **planin e trajtimit të personalizuar** (gjeometria e fushes të rrezatimit, dozat që duhen dhënë dhe kohëzgjatja e terapisë).

Përgjatë fazës tjetër që është simulimi do të verifikohen me pacientin të gjitha të dhënat e planit të kurës dhe do të behen imazhet radiologjike dixhitale.

Në mënyrë që të evidentohet çdo ditë pozicioni

i fushes manjetike, do të realizohen **tatuazhe të përherëshme me pika në lëkurë** me gjilpërë të hollë dhe me bojë shkrimi: lëkura mund të lahet pa friken se mund të fshihen keto shenja të rendesishme evidentimi.

Përgjatë **sesioneve të radioterapisë**, tekniku do të ndihmojë pacientin të sistemohet në pozicionin e duhur. Pozicioni duhet të mbahet konstant për të gjithë kohën e nevojshme për trajtimin, që zakonisht është disa minuta.

**Pacienti është gjithmonë i kontrolluar** nga një sistem monitorimi audio/video, me anë të këtij sistemi pacienti mund të komunikojë me mjekët që ndodhen në pozicionet e komandimit të paisjeve.

Radioterapia është një terapi pa dhimbje. Nuk është i nevojshëm shoqërimi i pacientit e as qëndrimi në spital pas trajtimit.

Terapia rrezatuese bëhet çdo ditë punë dhe kohëzgjatja mund të jetë nga 3 deri në 6 javë.

Gjate dhe pas terapisë është e mundur të vazhdohet jeta e zakonshme: mund të punohet, të merreni me familjen, me fëmijet dhe çdo aktivitet tjetër të zakonshëm ditor. Nuk ka rrezik radioktiviteti dhe mund të shoqëroheni me fëmijë dhe persona të çdo moshë pa frikë.

Përgjatë periudhës të radioterapisë pacienti do të kontrollohet rregullisht për të vlerësuar tolerancën kundrejt kurës: mjeku dhe infermieri do të keshillojnë pacientit nëse janë të nevojshme trajtime shtesë.

Në oraret kur janë hapur paisjet është gjithmone prezent në repart një mjek radioterapist të cilit mund ti drejtohen pacientet për çdo problem në lidhje me terapinë rrezatuese.

## EFEKTET KOLATERALE TË RADIOTERAPISË

*Radioterapia mund të provokojë efekte modeste kolaterale të përgjithshme: për një periudhë kohe pacienti mund të ketë një ndjenje lodhje dhe debolëse.*

*Keshilla jone është që pacienti të pushojë dhe të kërkojë ndihmë nëse ndjehet i lodhur. Nuk është e nevojshme që pacienti të marrë ilaçe për rikuperimin e energjive.*

*Mund të manifestohen shenja reaksioni të lëkurës me skuqje dhe iritim të lehtë njesoj si skuqja nga dielli.*

**Reaksionet e lëkurës** të rrezatuara janë graduale dhe subjektive: përgjatë javës së tretë/katërt të terapisë mund të evidentohen, kryesisht në zonën poshtë gjoksit dhe afër sqetullës, zona të irituara.

*Në keto raste lëkura bëhet pak me e errët dhe e thatë. Në zonën e gjoksit të rrezatuar mund të shfaqet një fryrje e lehtë dhe dhimbje e lehtë.*

*Këto efekte zgjidhen shpejt disa jave mbas radioterapisë dhe rezultati i trajtimit është i kënaqshëm për pjesën më të madhe të pacienteve.*

*Në disa raste, pas një periudhë kohe mund të shfaqen disa efekte të vonuara.*

*Gjoksi mund ndryshojë pak formën; lëkura mund të duket me elastike dhe mund të shfaqen disa shenja të vogla.*

*Falë saktësisë së planifikimit të dozave dhe teknikave të rrezatimit, efekte kolaterale në organe të tjera të shëndetshme janë shumë të ralla.*